



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Agjencia e Kosovës për Akreditim**  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

Data: 06.07.2017

Ref.: 549/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 51-të, të mbajtur më 23 Qershor 2017, mori:

**V E N D I M**

I. Nuk akreditohet programi i studimit i BPrAL Kolegji “Arbëri”:

- Infermieri, BSc. 180 ECTS.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

**Arsyetimi**

BPrAL Kolegji “Arbëri” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për riakreditim të programit të studimit: Infermieri, BSc. 180 ECTS, me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Infermieri	BSc	180	Halil Ajvazi, Zejdush Tahiri, dhe Agim Asllani

AKA ka organizuar vizitë në Kolegjin “Arbëri” më 08.05.2017, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit të cekur me sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Danica Zeleznik dhe Helvi Kyngas.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2017 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegji “Arbëri”, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë qar në mos dhënie e rekomandimit për akreditim:

Sipas ekspertëve programi i studimit në Infermieri nuk korrespondon me misionin e institucionit dhe se misioni i Kolegjit nuk adreson rëndësinë e arsimit të lartë për të rinjtë dhe hulumtimin shkencor, si dhe rëndësinë që ka në shoqërinë e Kosovës.

Për sa i përket stafit akademik, asnjëri nga stafi nuk ka PhD apo MA në fushën e infermierisë. Vetëm njëri nga pjesëtarët e stafit akademik ka Bachelor në Infermieri. Sipas rregullave të AKA-së çdo program i studimit duhet të ketë 3 PhD mirëpo dhe në anën tjetër sipas Direktivës Evropiane programi duhet të ketë staf akademik i cili përbëhet nga Infermierë (master në fushën e infermierisë apo shkencave mjekësore) si dhe bartësit e programit duhet të jenë të fushës së infermierisë me titull akademik. Ky kriter sipas ekspertëve nuk është përmbushur.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji "Arbëri";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



---

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë